**VENDIM**
**Nr.744, datë 30.10.2007**

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ANËTARËVE TË KOMITETIT KOMBËTAR TË TRANSFUZIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9739, datë 21.5.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Transfuzionit mblidhet rregullisht, 2 herë në vit, me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

2. Pagesa e anëtarëve të këtij Komiteti, për përgatitjen dhe zhvillimin e çdo mbledhjeje, të jetë në shumën 5000 (pesë mijë) lekë.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar, për këtë qëllim, për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**